



Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr.304/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje në përbërje z. Vedat Poterqoi – Kryetar, znj. Kimete Gashi – Referuese , znj. Vjosa Gradina Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Besioni- Konzorcium me N.T. Flamuri dhe Benita Company”SH.P.K.– Malishevë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Beni- Com”SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugëve në Shkabaj Alush Hoti dhe Hazir Haxholli”, me nr. të prok: 616-22-4689-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna Prishtinë”, më datën: 27.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I.REFUZOHET, si e pa bazuar ankesa e operatorit OE: “Besioni- Konzorcium me N.T. Flamuri dhe Benita Company”SH.P.K.– Malishevë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugëve në Shkabaj Alush Hoti dhe Hazir Haxholli”, me nr. të prok: 616-22-4689-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “Komuna Prishtinë”.

II.VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugëve në Shkabaj Alush Hoti dhe Hazir Haxholli”, me nr. të prok: 616-22-4689-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - “Komuna Prishtinë”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Operatorit ekonomik ankues: “Besioni- Konzorcium me N.T. Flamuri dhe Benita Company”SH.P.K.– Malishevë, konform nenit 33 pika 5 i bëhet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE: “Besioni- Konzorcium me N.T. Flamuri dhe Benita Company”SH.P.K.– Malishevë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 02.08.2022, me nr. 304/22 kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugëve në Shkabaj Alush Hoti dhe Hazir Haxholli”, me nr. të prok: 616-22-4689-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK - Prishtinë”.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 pika 1, 7 pika 1 ,51 ,59 ,60 , 62 ,si dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.08.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 16.08.2022, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: “Besioni- Konzorcium me N.T. Flamuri dhe Benita Company”SH.P.K.– Malishevë,

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues i pa kënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues ka parashtruar ankesë ne OSHP, ku pretendon se arsyeja e eliminimit nga AK-ja, e OE ankues është e pa drejtë dhe AK-ja nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, ku eliminohet me arsyetimin se: “ Nuk keni ofruar dëshmi të mjaftueshme, siç është parashikuar në nenin 69 të LPP. Autoriteti Kontraktues ka kërkuar Inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë ose Infrastrukturës me tri vite përvojë pune pas diplomimit. Ndërsa ju keni prezantuar Lekë Krasniqin i cili ka dy diploma masteri që janë të barasvlershme me diplomën e inxhinierit, por njëra e ka me datë 21.07.2021 dhe tjetrën me datë 25.06.2020, që i bie se ka më pak se tri vite përvojë pas diplomimit. Për këtë arsye është refuzuar tenderi juaj”.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: “Një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose infrastrukture rrugore - 3 vite përvojë pune pas diplomimit”. Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “Për menaxherin e projektit dhe inxhinierët ose bachelorat te dorëzohet CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt”. Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar në E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues për plotësimin e kësaj kërkesë të DT-së, për inxhinier të ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë rrugore, ka ofruar z. Lekë Krasniqi, për të cilin janë bashkangjitur dëshmitë si: CV-ja, Diplomë e studimeve post diplomike-Master e datës 21.07.2021, Diplomë e studimeve postdiplomike-Master e datës 25.06.2020, Diplomë e studimeve themelore Universitare e datës 4 Dhjetor 2006, kontratë për punë të pa caktuar, si dhe janë ofruar certifikata dhe referenca për punën e z. Krasniqi. Eksperti shqyrtues, sqaron se z. Krasniqi nuk e përmbushë kërkesën e DT-së për faktin se nga momenti i pajisjes së tij me diplomë të studimeve post diplomike master e cila është e barasvlershme me titullin inxhinier, e deri tek njoftimi për kontratë nuk ka arritur të dëshmojë që i ka 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “BESIONI SHPK (në konzercium me N.T Flamuri dhe Benita Company sh.p.k” Malishevë, të refuzohet si e pa bazuar, dhe rekomandon që të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 17.08.2022 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datën 19.08.2022 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 26.09.2029, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se:

Lidhur për të gjitha pretendimet kryesore ankimore të operatorit ekonomik ankuese paneli shqyrtues i klasifikon si të pa bazuara dhe mbështetet në raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues të caktuar nga OSHP, detyrë e të cilit ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe mendimi i tij profesional është që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, në të njëjtën kohë të mbetet

në fuqi vendimi i AK-së. Kështu që, edhe arsyetimet e dhëna nga eksperti shqyrtues llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – “KK- Prishtinë”,
- 1x1 OE – “Besioni- Konzorcium me N.T. Flamuri dhe Benita Company”SH.P.K.– Malishevë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së,
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

